

Viti i I

Semestri I

Bazat e infermierisë	
<i>Në këtë modul mësohet për rëndësinë e shëndetit, studentët mësojnë për karakteristikat e praktikës infermiere profesionale dhe rolin e infermierise lidhur me teorinë infermiere, studentët aftësohen të zhvillojnë punë praktike profesionale. Në këtë modul poashtu mësohet për modelet teorike dhe 4 konceptet bazë të procesit infermior. Studentët aftësohen të transferojnë njohuritë teorike dhe njohuritë e fituara në situatat e stimuluar të praktikës gjatë kujdesit të pacientit.</i>	12 ETC's
Etika dhe filozofia në kujdesin infermior në përputhje me legjislacionin e kujdesit shëndetësor	
<i>Në këtë modul mësohet rreth marrëdhënieve në mes kujdesit infermior dhe etikës, identifikohen vlerat themelore të kujdesit infermior, bëhet dallimi në mes vlerave personale dhe profesionale. Në legjislacionin në shëndetësi do të jenë të futur në bazat ligjore të sistemit ku mësojnë për të drejtat dhe detyrimet e stafit të kujdesit shëndetësor. Në këtë modul jepen njohuritë për parimet themelore të ligjit të punës, mënyrën e hyrjes apo ndërprerjes së një marrëdhënie të punës, të drejtat dhe detyrimet</i>	3 ETC's
Mikrobiologji dhe parazitologji	
<i>Në këtë modul studentët do të familjarizohen me karakteristikat themelore të mikrobeve; me agjentët e infeksioneve të zakonshme dhe mekanizmat e shfaqjes, sipas vendndodhjes anatomike; kuptojnë përgjigjen e sistemit imunitar ndaj infeksionit dhe mësojnë rreth diagnostifikimit të infeksionit. Studentët poashtu mësojnë metodat themelore për mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave epidemiologjike të infeksioneve nozokomiale; mësojnë në lidhje me pastrimin, dezinfektimin, dekontaminimin dhe sterilizimin</i>	3 ETC's
Programi diagnostiko-terapeutik	
<i>Tek ky modul studentët do të kryejnë të pavarur ndërhyrjet infermiere tek pacientat që kërkojnë shërbimë të mjeksësisë interne; njoftohen me smundjet specifike dhe të dhënat e nevojshme për infermierët. Studentët në këtë modul fitojnë aftësi për të kryer ekzaminime të përgjithëshme fizike</i>	3 ETC's
Metodat në edukimin dhe promovimin shëndetësor	
<i>Në këtë modul studentët do të kuptojnë zhvillimin bazë për të njohur dhe përcaktuar edukimin shëndetësor, pedagogjinë, didaktikën, pedagogjinë e veçantë dhe këshillimin. Studentët do të mësojnë rreth qasjeve të promovimit të shëndetit dallojnë edukimin shëndetësor, infermior dhe promovimin e shëndetit; përdorin teorinë e pedagogjisë, didaktikës</i>	3 ETC's
Gjuhë angleze	
<i>Në këtë modul studentët do të marrin aftësi aktive dhe pasive të gjuhës; janë në gjendje të përdorin terminologjinë infermiere dhe terminologjinë mjeksore; mund të lexojnë referencat profesionale në gjuhën angleze gjatë studimeve universitare dhe në punë; fitojnë aftësinë për të bërë dallimin në mes regjistrave të ndryshëm dhe përdorimit të tyre gjatë komunikimit me pacientë / klientë dhe profesionistë të kujdesit shëndetësor</i>	3 ETC's

Semestri i II

Kujdesi për të moshuarit, Gerantologjia dhe Rehabilitimi	
<i>Studentët do të familjarizohen me kujdesin e plotë tek të moshuarit; dhe me konceptin e plakjes active, me planin për ruajtjen e shëndetit të pacientëve kronik; poashtu do të familjarizohen me komunikimin e duhur me të moshuarit; dhe me procedurat e kujdesit infermieror për sindromat geriatrike. Në këtë modul studentët do të kuptojnë dallimet mes sëmundjeve tek të rriturit dhe tek të moshuarit; dhe do të kuptojnë dallimin në mes të plakjes dhe sëmundjeve në pleqëri</i>	24 ETC's
Anatomi, Fiziologji dhe Patologji	
<i>Studentët do të kuptojnë konceptet themelore dhe definicionet e anatomisë dhe histologjisë; do të kuptojnë anatominë bazë; do të zbatojnë njohuritë e fituara në studimet e avancuara të infermierisë dhe ato në pjesët mjekësore; do të përdorin njohuritë teorike në praktikë. Poashtu studentët do të familjarizohen me parimet moderne të patologjisë; do të familjarizohen me etiopatogjenezën e sëmundjeve të zakonshme; do të marrin njohuri rreth proceseve themelore patologjike; do të marrin njohuri mbi procedurat diagnostikuese në patologji.</i>	3 ETC's
Moduli zgjedhor II	
	3 ETC's

Viti i II

Semestri i III

Kujdesi infermieror për fëmijët dhe adoleshentët	
<i>Në këtë modul studentët do të njoftohen me konceptet themelore lidhur me çështjet e Kujdesit infermieror për shëndetin e gruas;do të bëjnë Identifikimin,analizimin,krahasimin dhe argumentimin e njohurive të fituara.Studentët do të dinë kuptimin dhe përvetësimin e njohurive mbi konceptet themelore në Kujdesin infermieror për shëndetin e gruas.</i>	9 ETC's
Kujdesi infermieror për shëndetin e gruas,Gjinekologji dhe Obstetrik	
<i>Në këtë modul studentët do të familjarizohen me kujdesin themelor të grave,do të mësojnë qasjen dhe metodat e kujdesit infermieror të grave;do të fitojnë aftësi për të vlersuar në mënyrë kritike;do të mësojnë për diagnoza të caktuara dhe nderhyrjet e mundëshme.</i>	15 ETC's
Organizimi,Menaxhimi dhe udhëheqja në shëndetësi dhe kujdesi infermieror	
<i>Në këtë modul studentët do të familjarizohen me rezultat nga hulumtimet më të fundit për menaxhimin dhe udhëheqjen;do të kuptojnë menaxhimin e kujdesit shëndetsorë dhe infermieror.Studentët do të kuptojnë rëndësinë e udhëheqjes së një menaxheri të sukseshëm në kujdesin infermieror dhe do të jenë në gjendje të kuptojnë teorinë e udhëheqjes dhe menaxhimit në sistemin e kujdesit infermieror</i>	3 ETC's
Moduli zgjedhor III	
	3 ETC's

Semestri i IV

Kujdesi infermieror tek pacientët me sëmundje e mbrendshme	
<i>Në këtë modul aplikohen njohuritë shkencore dhe ekspertizën klinike për diagnostifikim,trajtim dhe kujdesin empatik ndaj personave adult në të gjithë spektrin nga shëndeti deri në smundjet komplekse</i>	18 ETC's
Psikologji në infermieri dhe kujdesin shëndetësorë	
<i>Studentët do të jenë të vetëdijshëm dhe të kuptojnë rëndësinë e psikologjisë dhe të aftësive psikologjike në kujdesin infermieror; kuptojnë konceptet themelore psikologjike, strukturat dhe dinamikën e personalitetit</i>	3 ETC's
Sociologjia e shëndetit dhe sëmundjeve	
<i>Studentët do të kuptojnë përcaktuesit social të shëndetit dhe smundjeve;përcaktuesit psiko-social të smundjeve. Do të familjarizohen sesi faktorët social ndikojnë në lidhje interpersonale të profesionistëve të kujdesit shëndetsor. Në këtë modul studentët do të kuptojnë aspektet sociale të teknologjisë mjeksore.</i>	3 ETC's

Moduli zgjedhor IV	3 ETC's
Moduli zgjedhor V	3 ETC's

Viti i III

Semestri i V

Kujdesi infermieror tek shëndeti mental dhe Psikiatria	
<i>Studentët do të familjarizohen me masat parandaluese për ruajtjen e shëndetit mendor; do të mësojnë nevojat specifike të pacientëve me çrregullime mendore; do të mësojnë teknikat terapeutike të komunikimit dhe dinamikën e punës ekipore; do të; familjarizohen me rrjetin "caregiving" për "të handikepuarit mendor" në mjedisin e tyre</i>	12 ETC's
Infermiera në kujdesin Shtëpiakë	
<i>Studentët do të mësojnë në lidhje me rolin dhe rëndësinë e infermierëve në komunitet për sistemin e kujdesit shëndetësor; dhe do të jenë në gjendje të njohin dhe integrojnë konceptet sociale shkencore dhe teoritë në provat e fundit kërkimore. Në këtë modul studentët do të familjarizohen me kujdesin infermieror të komunitetit; dhe do të jenë në gjendje të njohin dhe aplikojnë teoritë e kujdes infermieror në kujdesin shëndetësor në komunitet.</i>	12 ETC's
Udhëheqja në kujdesin infermieror	
<i>Studentët do të familjarizohen me qasjet moderne dhe me evidencat e fundit të menaxhimit dhe udhëheqjes; do të kuptojnë menaxhimin e organizatave jofitimprurëse: menaxhimin e kujdesit shëndetësor dhe menaxhimin infermieror; do të mësojnë në lidhje me menaxhimin e kujdesit shëndetësor në mjedisin social; dhe do të kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të integritetit të kujdesit shëndetësor me menaxhimin infermieror</i>	3 ETC's
Moduli zgjedhor VI	3 ETC's

Semestri i VI

Kujdesi infermieror në kirurgji	
<i>Studentët do të mësojnë principet dhe definicionet bazike për kirurgji; do të mësojnë teknikat bazë për kirurgjinë; do të familjarizohen me principet dhe metodat e anestezionit. Në këtë modul studentët do të jenë të aftë të përdorin njohuritë e tyre në përcaktimin e ndryshimeve mjeksore të pacientit dhe do të dinë të përdorin njohuritë teorike në praktikë.</i>	18 ETC's
Ndihma urgjente dhe kujdesi shëndetsor në sirkumstanca të vecanta	
<i>Studentët do të mësojnë parimet themelore dhe definicionet e kirurgjisë për kujdesin emergjent mjekësor; do të mësojnë procedurat themelore për kujdesin emergjent mjekësor në situata emergjente të ndryshme; dhe do të mësojnë se si shërbimet emergjente mjekësore funksionojnë në rastet e incidenteve me viktima. Në këtë modul studentët do të përdorin njohuritë teorike dhe praktike të kujdesit emergjent mjekësor në praktikë dhe do të rregullojnë praktikën e vendosur në bazë të evidencave të reja në fushën e mjekësisë së kujdesit emergjent</i>	3 ETC's
Moduli zgjedhor VII	3 ETC's
Punim diplome	6 ETC's